



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2026

Datë: 31.03.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në Nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 pas diskutimit lidhur me pikën e 7 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Palëve në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës Komunale, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të palëve në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale në Komunën e Gjakovës, me këtë përbërje:
 1. z. Gjevalin Nikollbibaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës.
 2. z. Ervin Shabani, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës.
 3. znj. Barbana Peja, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 4. z. Shkëmbin Rama, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
 5. znj. Erblina Dinarama, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.
2. Ky komision ka për detyrë dhe përgjegjësi që të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të Pronës së paluajtshme Komunale, siç përcaktohet me legjislacionin në Fuqi.
3. Ky komision ka mandat dy vjeçar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisionit .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .



Shefqet Shehu

Kryesues i Kuvendit të Komunës